



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



KUVENDI KOMUNAL PEJË

I. Numër:400/01-31126, datë: 29 Maj 2026.

Në bazë të nenit 12. pika 2 (d), neni 17 paragrafi 1 pika (s) të Ligjit Nr.03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës datë: 04.Qershor 2008 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 datë: 04.Qershor 2008”), Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, date 11.07.2019) , nenit 20 paragrafi 1, pika 1.4. të Statutit të Komunës së Pejës, Kuvendi i Komunës së Pejës në mbledhjen e mbajtur më 29 Maj 2026, aprovoi:

VENDIM

Nr.36/2026

Mbi Miratimin e Planit Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integritit të të huajve në Pejë 2026 - 2028

1. MIRATOHET Plani Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integritit të të huajve në Pejë 2026 – 2028.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Planii Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integritit të të huajve në Pejë 2026 – 2028.
3. Për Zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra për Komunitete dhe Kthim e Komunës së Pejës.
4. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

1x1. MAPL.

1x1. Kryetarit të Komunës.

1x1.Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

1x1. Arkivë.



KRYESUESI KUVENDIT,
Z. Rexhep Kurtbogaj